



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Sh.II.nr.147/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, në çështjen përmbartimore të kreditorit Barileva shpk me seli në Prishtinë, fshati Prugovc, kundër debitorit Vëllëzërit Dervishaj shpk me seli në Pejë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Mustaf Kastrati avokat nga Peja, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale- Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1628/22 të datës 30.06.2023, me datën 12.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e debitorit Vëllëzërit Dervishaj shpk me seli në Pejë, ANULOHET aktvendimi i Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1628/22 i datës 30.10.2023, dhe Lënda kthehet ne rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Dhoma e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar, KPPP.nr.1628/22 të dt.30.10.2023, ka vendosur si në vijim: Hedhet Poshtë si i pasafatshëm prapësimi i debitorit Vëllëzërit Dervishaj shpk me seli në Pejë, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.158/22 i datës 17.06.2022 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Eset Murati.

Ankesë ka paraqitur në afat ligjor i autorizuari i debitorit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të LPK-së, verifikimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, dhe i propozon gjykatës, që të merr aktvendim me të cilin aprovon ankesën e debitorit si të bazuar, ta prish aktvendimin KPPP.nr.1628/22 i datës 30.10.2023 në tërësi si të pabazuar dhe çështja të kthehet ne rigjykim ose të ndryshohet aktvendimi i kundërshtuar dhe të refuzohet propozimi për përmbartim i kreditorit si i pabazuar.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për procedurën përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori kreditorit Barileva shpk me seli në Prishtinë, fshati Prugovc, me datën 17.06.2022 ka paraqitur propozim për përbarim ndaj debitorit Vëllëzërit Dervishaj shpk me seli në Pejë, mbi bazën e faturave nr.129/21 dt.06.04.2021 dhe nr.159/21 dt.12.04.2021, në shumën prej 1,307.50€, si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës përbarimore.

Përbaruesi Privat Eset Murati, me Urdhrin Përbarimor P.nr.158/22 të datës 17.06.2022, ka lejuar përbarimin, duke vlerësuar se dokumenti përbarues fatura, i plotëson kushtet për përbarim.

Kundër këtij urdhri përbarimor, debitori ka paraqitur prapësim duke e kundërshtuar në tërsi urdhrin përbarimor për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të LPP-së dhe LPK-së. Deklaron se debitori nuk është në raport juridik me kreditorin dhe asnjëherë nuk ka porositur dhe pranuar mall nga kreditori e që vërtetohet me faturat e bashkangjitura, ku askund nuk figuron nënshkrimi i debitorit, i propozon gjykatës që prapësimin ta aprovoj në tërsi si të bazuar ndërsa ta shfuqizoj urdhrin për lejimin e përbarimit.

Kreditori në përgjigje në prapësim, deklaron se urdhri është lejuar në përputhje me dispozitat e nenit 22,27 dhe 38 të LPP-së. Debitori e ka pranuar mallin dhe i ka nënshkruar faturat me datë 06.04.2021 dhe 12.04.2022. Prapësimi i debitorit nuk është i mbështetur me prova ashtu siq kërkohet me nenin 69 par.4 të LPP-së, andaj i propozon gjykatës që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1628/22 të datës 30.10.2023 e ka Hedh Poshtë si i pas afatshëm prapësimin e debitorit Vëllëzërit Dervishaj shpk me seli në Pejë, i paraqitur kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.158/22 i datës 17.06.2022 i lejuar nga Përbaruesi Privat Eset Murati.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, Dhoma e shkallës së parë, thekson se prapësimi i debitorit është i pas afatshëm duke u referuar në nenin 70 të LPP-së. Debitori e ka pranuar urdhrin përbarimor me datën 17.06.2022 fakt ky që vërtetohet nga fletëkthesa për dorëzim personal të përbaruesit privat, ndërsa debitori prapësimin e ka paraqit përmes postës rekomand me datën 01.07.2022, fakt ky që vërtetohet nga zarfi i postës me numër R-224533.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkallës së parë, rreth vlerësimit të provave në lëndë, nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që ekzistojnë kontradikta mes dispozitivit dhe arsyesimit të vendimit, lidhur me datën e pranimit të urdhrin përbarimor P.nr.158/22 dhe datën e ushtrimit të prapësimin

të debitorit, e të cilat shkelje thelbësore kanë ndikuar që të anulohet aktvendimi i atakuar në vështrim të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 1 të LPK-së, e lidhur me nenin 70 LPP-së.

Dhomat e shkallës së dytë, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës respektivisht fletë kthesa në lëndë, rezulton se debitori e ka pranuar-nënshkruar me datën 23.06.2022 Urdhrin përmbarimor P.158/22 i lejuar me datën 17.06.2022, gjithashtu në fletëkthesë ekziston edhe një vërejtje tjetër e nënshkruar nga dorëzuesi me datë 22.06.2022. Ndërsa debitori prapësimin tek Përmbaruesi Privat e ka dorëzuar nëpërmes postës me datë 01.07.2022, që vërtetohet me dërgesën postare R-224533, prandaj nga këto fakte nuk mund të pranohet qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë se debitori e ka pranuar me datën 17.06.2022 urdhrin përmbarimor, ndërsa urdhri përmbarimor P.158/22 është lejuar me datën 17.09.2022.

Në ri procedurë, Dhoma e shkallës së parë udhëzohet që duke pasur parasysh shkeljet e konstatuara si më lartë, të eliminoj mangësitë e gjetura, të vlerësoj me kujdes provat e lëndës, dhe të vendos edhe njëherë lejueshmërin e prapësimin të paraqitur nga debitori, gjithnjë duke vlerësuar edhe shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës, për të cilat gjykata çdoherë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1, pika d) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së dytë

K.Dh.Sh.II.nr.147/24 datë 12.06.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha